



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

---

Numri i lëndës: 2018:020516

Datë: 27.07.2018

Numri i dokumentit: 00091145

**P. nr.46/18**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË-Departamenti i Përgjithshëm**, Gjyqtarja **Ilirjana Hoti**, me sekretaren juridike Flutur Nagavci, në çështjen penale kundër të akuzuarit U. Q. nga ... K Gjakovë, për shkak të veprës penale sulm ndaj pësonit zyrtar gjate kryerjes se detyrës zyrtare nga neni 410/1 të KPRK-ës si, sipas Aktakuzës të Prokurorisë Themelor-DP në Gjakovë, PP.nr.21/18 të dt.26.01.2018, në shqyrtimin fillestar të mbajtur më datë **24.07.2018**, në prani të Prokurorit të shtetit Bajram Kryeziu dhe te akuzuarit U. Q., të njëjtën ditë mori dhe shpalli këtë:

**A K T G J Y K I M**

I akuzuari **U Q.** nga ... K Gjakovë, i biri i G. dhe i nënës L. e gjinisë P, data e lindjes.... ne Gjakovë, ka te kryer shkollën e mesme, bujk, i gjendjes se dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i R. Kosovës, i martuar atë i 5 fëmijëve, me nr. ID .....

**Ë s h t ë f a j t o r:**

**Sepse:**

- **Me dt. 10.09.2017, rreth orës 22.20**, ne Gjakovë, pikërisht ne spitalin rajonal .... në Gjakovë, sulmon personin zyrtar gjate kryerjes se detyrës zyrtare, përkatësisht zyrtarin policor A. B., ne atë mënyrë qe natën kritike derisa zyrtaret policor ishin njoftuar se ne spitalin rajonal ... ka ardhur një person me lëndime te renda trupore, te njëjtit ju kishin përgjigjur thirrjes, në te shkuar aty zyrtari policor A. B. kishte kërkuar nga i akuzuari informacione lidhur me atë çka ka ndodhur, i akuzuari i revoltuar fillimisht e fyen me fjalë “ik largohu se “ q ..... nonen “ aty ndërhyjnë zyrtarët policor K. Th. dhe K Sh., dhe stafi mjekësor dhe nuk e lejojnë te akuzuarin te ngritet ne këmbë, mirëpo i njëjti prapë është ngritur ne këmbë, e ka nxjerr rripin e pantallonave dhe i është drejtuar zyrtareve policor hajde “tjau q ..... nonen qetash “, derisa kanë ndërhy njësiti policor i hetimeve dhe ka venë situatën nen kontroll.

**-me çka ka kryer veprën penale sulm ndaj personit zyrtar gjatë kryerjes se detyrës zyrtare nga neni 410/1te KPRK-ës.**

Andaj Gjykata në mbështetje te nenit 4,17,41,45,73, dhe nenit 410/1 të KPRK-ës, te akuzuarit i shqipton :

## DENIM ME KUSHT

Dënim me burgim ne kohëzgjatje prej 120(**njëqind e njëzet**) ditësh , i cili dënim nuk do të ekzekutohen nëse i akuzuari brenda kohës se verifikimit në afatin prej **1 (një) viti** ,nuk kryen ndonjë veprë tjetër penale

I dëmtuari , për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

Detyrohet i akuzuari që ti paguajnë shpenzimet procedurale te përcaktuara nga ana e gjykatës dhe në emër të paushallit gjyqësor shumë prej nga **30,00.-€**, në afat prej **15** ditësh, e krejt këtë pas plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi.

### A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjakovë, me aktakuzën PP/IL.nr.21/18 të dt. 26.01.2018 e ka akuzuar të akuzuarin U. Q. nga ..... K Gjakovë, për shkak të veprës penale sulm ndaj personit zyrtar gjate kryerjes se detyrës zyrtare nga neni 410/1 të KPRK-ës ,duke propozuar që i akuzuari të shpallet fajtor dhe te dënohet sipas ligjit .

Gjatë shqyrtimit fillestar me dt.24.07.2018, përfaqësuesi i PTH-DP, në Gjakovë , Prokurori Bajram Kryeziu lexojë aktakuzën PP/IL.nr. 21/18 te dt. 26.01.2018 dhe deklaroi se mbetet në tërësi pranë aktakuzës

I akuzuari U. Q., gjate shqyrtimit fillestar, deklaroi se e pranon ne tërësi fajësinë sipas aktakuzës me të cilën pandehet duke i ditur edhe me parë pasojat e pranimi te fajësisë ne mënyrë vullnetare dhe pa presion , shtojë se si ne çdo fazë te procedurës me pranimin e fajësisë jam penduar për veprën e kryer ne afekt dhe atë ne gjendje te rende shëndetësore me lëndime te renda trupore te pësuar ditën kritike ku edhe isha ne trajtim mjekësor ku te njëjtën ditë nga vet zyrtaret policor me ekipin mjekësor jam dërguar ne QKUK- Prishtinë ,andaj me pranimin e fajësisë jam penduar për veprën e kryer ne afekt për çka edhe i kërkojë falje te dëmtuarit për veprimet e mijja ,premtojë se një veprim i tillë nuk do te përsëritet dhe ne te ardhmen do te jem me i kujdesshëm ,me te njëjtin asnjëherë me pare nuk kam pasur problem dhe as qe do te kem ,kështu qe me rastin e shqiptimit te dënimit i propozoi gjykatës te merr parasysht rrethanat lehtësuese si pranimi i fajësisë , pendimi i shprehur ne gjykate për veprën e kryer kërkimi falja nga i dëmtuarit si dhe faktin se me pare nuk se nuk jam dënuar nga ana e gjykatës .

Prokurori i shtetit Bajram Kryeziu deklaroi se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë nga i akuzuari pasi qe i njëjti është i vetëdijshëm për pasojat dhe favorret juridike te pranimi te fajësisë ,dhe se aktakuza ka mbështetje ne provat materiale qe gjenden ne shkresat e lendes.

Në shqyrtimin fillestar gjykata ka vërtetuar këtë gjendje faktike :

Ne tërësi u vërtetua se i akuzuari U. Q. ,me dt. **10.09.2017 ,rreth orës 22.20**, ne Gjakovë ,pikërisht ne spitalin rajonal .... ne Gjakovë ,sulmon personin zyrtar gjate kryerjes se detyrës zyrtare, përkatësisht zyrtarin policor A. B. ,ne atë mënyrë qe natën kritike derisa zyrtaret policor ishin njoftuar se ne spitalin rajonal ..... ka ardhur një person me lëndime te renda trupore ,te njëjtit ju kishin përgjigjur thirrjes ,në te shkuar aty zyrtari policor A. B. kishte kërkuar nga i akuzuari informacione lidhur me atë çka ka ndodhur , i akuzuari i revoltuar fillimisht e fyen me fjalë “ik largohu se “q ..... nonen “ aty ndërhyjnë zyrtarët policor K.Th. dhe K. Sh. , dhe stafi mjekësor dhe nuk e lejojnë te akuzuarin te ngritet ne këmbë, mirëpo i njëjti prapë është ngritur ne këmbë , e ka nxjerr rripin e

pantallonave dhe i është drejtuar zyrtareve policor hajde “ tja q ..... nonen qetash “,derisa ka ndërhy njësiti policor i hetimeve dhe ka venë situatën nen kontroll.

Gjykata gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar nga vet pranimi i fajësisë nga i akuzuari i cili ne shqyrtimin fillestar vullnetarisht ka pranuar fajësinë ,për shkak te se cilës gjykata nuk ka administruar provat ,gjykata ka ardhur ne përfundim se pranimi i fajësisë nga i akuzuari është bere ne pajtim me nenin 248 te KPPK-ës. Gjate pranimit te fajësisë gjyqtari i vetëm gjykues konstatojë se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit te fajësisë ,pranimi është bere vullnetarisht nga i akuzuari, pranimi i fajësisë mbështetet ne faktet dhe provat qe i përmban aktakuza ,ne materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje te qarte ligjore ose gabime faktike .

Gjykata nga te cekurat me lartë ka ardhur ne përfundim se ne veprimet e te akuzuarit formohen te gjitha elementet e veprës penale te përshkruara si ne dispozitiv te këtij aktgjykimi dhe për këtë ka vendosur qe te akuzuarin ta shpalle fajtor dhe ta gjykojë ne bazë te ligjit ,me pare duke vërtetuar përgjegjësisë penale juridike te tij.

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj te akuzuarit ,gjykata ka pasur parasysh të gjitha rrethanat nga neni 73 të KPK-së ,të cilat ndikojnë në zbutjen apo ashpërsimin e dënimit .Rrethana rënduese nuk gjeti ndërsa si rrethana lehtësuese gjykata ka marrë parasysh pranimin e vullnetshëm të fajësisë në çdo fazë te procedurës nga i akuzuari, pendimin e tij për veprën e kryer ne afekt dhe ne gjendje te rende shëndetësore , sjelljen korrekte të akuzuarit në gjykim , kërkim falja nga i dëmtuari, premtimi se një veprim i tillë nuk do të përsëritet, gjendja e varfër ekonomike ,faktin se i njëjti me pare nuk ka qene i dënuar , kështu që duke mos gjetur rrethana posaçërisht rënduese gjykata ka ardhur në përfundim se me dënimin me burgim në kohëzgjatja prej 120 (njëqind e njëzet )ditësh, i cili dënim nuk do te ekzekutohet nëse i akuzuari brenda kohës se verifikimit ne afatin prej 1(një ) viti nuk kryen vepër tjetër penale , me shprese dhe bindje se edhe me këtë dënim do ta arrihet qëllimi i dënimit i parapare me dispozitat e nenit 41 te KPK-se.

Vendimi për udhëzimin e palës së dëmtuar në kontest civil për realizimin e kërkesës pasurore juridike, është marr komfor nenit 463 par. 2 të KPPK-së .

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushalli gjyqësor bazohet në dispozitat e nenit 450 par.1dhe 2 nën paragrafi 2.6 te KPPK-së.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi .

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË,  
P. nr.46/18 më datë 24.07.2018.**

**Sekretarja juridike,  
Flutur Nagavci**

**Gj y q t a r j a,  
Ilirjana Hoti**

**KËSHILLA JURIDIK:** Kundër këtij Aktgjykimi mund të paraqitet ankesë ,në afatin prej **15 ditësh**, nga dita e marrjes se tij ne dorëzim ,Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Ankesa në kopje të mjaftueshme i dorëzohet kësaj Gjykate.

Numri i lëndës: 2018:020516  
Datë: 27.07.2018  
Numri i dokumentit: 00091145